

Plani për themelimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore (ZAMV)

Qëllimi:

Ky dokument nënvizon planin për themelimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore (ZAMV). Pritet që ky plan do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara qytetarëve të Mitrovicës Veriore në një mënyrë transparente dhe të përgjegjshme.

Qasja:

Struktura e përkohshme komunale për Mitrovicën Veriore është e bazuar në objektivat e mëposhtme:

- Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore me transparencë dhe përgjegjshmëri do t'i shërbejë të gjithë qytetarëve si dhe të veprojë si qendër komunale për të gjitha shërbimet e ofruara në nivelin lokal, në bashkëpunim me zyrat e ministrive përkatëse (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Infrastrukturës);
- Parimet e qeverisjes së mirë do të respektohen, me theks të veçantë në sundimin e ligjit;

Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore (ZAMV) do t'iu ofrojë shërbime qytetarëve. Financimi i ZAMV-së do të bëhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet krijimit të një linje buxhetore, sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

ZAMV-ja do të organizohet në shtatë (7) drejtori (ju lutem referojuni Shtojcës I). Fillimisht, ZAMV-ja do të ketë 55 punëtorë (ju lutem referojuni Shtojcës 1) në përputhje me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe Vendimin #10/46 të datës 3 dhjetor 2008 të Qeverisë për Përcaktimin e Kriteve për numrin e punëtorëve në administratën komunale. Numri i përgjithshëm i stafit të ZAMV-së, në fazën e mëvonshme, do të arrijë 80 punëtorë që do të jetë e krahasueshme me komunat e madhësisë së ngjashme sikurse që është Graçanica ose Obiliqi. Punësimi i stafit do të bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e Ligjit për Shërbimin Civil.

ZAMV-ja do të menaxhohet nga një Zyrtar Kryesor Ekzekutiv, i cili do të ushtrojë përgjegjësitë e njëjta si të Kryetarit të komunës, në përputhje me nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Shih shtojcën IV, pika # 5), që përfshinë:

- Përfaqëson dhe vepron në emër të ZAMV;
- Propozon nivelin e pagesave dhe ngarkesave, buxhetin, planet zhvillimore, rregullative dhe investuese, planin vjetor të punës dhe i raporton MAPL-së për miratim; organizon punën e ZAMV dhe ekzekuton buxhetin dhe politikën lokale dhe administrative të ZAMV;

Zyrtar Kryesori Ekzekutiv i ZAMV-së do të përzgjedhet përmes një procesi transparent dhe konkurrues të organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërkaq kandidati i përzgjedhur do të emërohet nga Qeveria e Kosovës në koordinim me ZCN-në.

Zyrtari Kryesor Ekzekutiv i ZAMV-së parapëlqehet të jetë së paku 3 vite qytetar/banor i Mitrovicës Veriore si dhe të jetë pjesëtar i grupit etnik shumicë në Mitrovicën Veriore i cili/e cila duhet të jetë në gjendje të pëfaqësojë të gjitha komunitetet etnike. Kriteret e përzgjedhjes përgatiten nga MAPL-ja (Shih Shtojcën II) dhe janë pjesë e vendimit të Qeverisë së Kosovës për themelimin e ZAMV-së. Po ashtu, drejtorët e Drejtorive brenda ZAMV-së do të përzgjedhen përmes një procesi transparent dhe konkurrues të rekrutimit.

Zyrtari Kryesor Ekzekutiv do të mbështetet nga një këshilltar ndërkombëtar i emëruar nga Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal. Këshilltari ndërkombëtar do të jetë përgjegjës për ofrimin e mbështetjes teknike për Zyrtarin Kryesor Ekzekutiv dhe Drejtorët e Drejtorive të ZAMV-së. Ky person do të shërbejë si burim kryesor për Zyrtarin Kryesor Ekzekutiv për realizimin efektiv të të gjitha aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve të miratuara për t'u zbatuar në ZAMV. Ai/ajo do të ndihmojë në identifikimin dhe zhvillimin e mjeteve dhe metodave për forcimin e administratës komunale, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe promovimin e zhvillimit ekonomik lokal. Ai/ajo gjithashtu do të sigurojë se çasjet dhe novacionet e identifikuar për zbatim të jenë teknikisht të duhura dhe në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Siç parashikohet në Shtojcën III, nenin 13 të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe në nenin 7 të Ligjit për kufijtë komunal, (Shih Shtojcën IV, pikën # 6), **një bord funksional i përbashkët i Mitrovicës** do të themelohet për bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Mitrovicës dhe ZAMV-së në fushat e kompetencave komunale përkatëse.

Baza ligjore për ZAMV-në:

Sipas kornizës ligjore të Kosovës në mënyrë specifike Ligjit për Kufijtë Administrativ Komunal, nenin 13 dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Shtojcën III, nenin 12.2.2 (Shih Shtojcën IV, pikën 7), funksionet ekzekutive të komunave të reja dhe ofrimi i shërbimeve publike janë përgjegjësi e komunës “nënë” derisa të themelohet komuna e re. Kjo do të thotë se Komuna e Mitrovicës aktualisht ushtron autoritet ekzekutiv në lidhje me kompetencat “vetanake” dhe “të deleguara” mbi territorin në të cilin eventualisht do të themelohet komuna e re e “Mitrovicës Veriore.”

Në mënyrë që mekanizmi i përkohshëm administrativ në komunën e Mitrovicës Veriore të jetë në gjendje të ushtrij autoritetin ekzekutiv atje, duhet që së pari të bëhet një delegim nga komuna e Mitrovicës në organet e përkohshme. Baza për këtë delegim është në nenin 50.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale. Në këtë dispozitë thuhet:

Nëse kuvendi komunal dështon në kryerjen e funksionit të detyrueshëm sipas standardeve të përcaktuara me ligj, apo nëse bëhet jofunksionale dhe kështu rrezikon ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve, ministria përgjegjëse për qeverisje lokale njofton komunën për dështimin dhe kërkon që të ndërmerren masa të duhura

në mënyrë që të sigurohet kryerja normale e funksionit të sfiduar.(Theksi është shtuar)

Si rezultat i situatës politike në Kosovën Veriore, Kuvendi Komunal i Mitrovicës nuk ka qenë në gjendje të ofroj përkrahje dhe shërbime të caktuara themelore për qytetarët në pjesën veriore të kufijve të saj çka e “ka rrezikuar ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve.” Prandaj, MAPL-ja duhet të lajmëroj Komunën për pamundësinë e saj për të vepruar dhe të kërkojë që të ndërmerren masat e duhura. Në këtë rast, MAPL-ja mund të vendos se njëra nga masat e duhura është delegimi i disa funksioneve të caktuara në ZAMV.

Duhet të vihet në pah se sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 40 (Shih Shtojcën IV, pika 1), janë disa funksione të cilat Kuvendi Komunal nuk mund t’i delegoj. Megjithatë, është e mundur të argumentohet se një delegim i tillë do të ishte i pranueshëm (dhe kërkuar) sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Shtojca III, neni 12.2. Kjo dispozitë kërkon që autoritetet e Kosovës dhe Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (ICR) do të bëjnë të gjitha “përgatitjet e nevojshme” për të siguruar se . . . “janë krijuar dhe ndarë burimet, pronat dhe strukturat administrative të nevojshme për themelimin dhe funksionimin e komunave të reja” përpara zgjedhjeve lokale. Nëse Qeveria përcakton se krijimi i një mekanizmi të qeverisjes së përkohshme është “përgatitje e nevojshme” për komunën e re, duhet të ndërmarr hapa që të formojnë këto struktura.


Tani për tani ligji bazik për organizimin dhe funksionimin e komunave në Kosovë është Ligji për Vetëqeverisje Lokale (i miratuar në 2008) i cili përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve komunale.

Aktualisht, Ministria e Financave ka një linjë të veçantë buxhetore për komunën e Mitrovicës Veriore. Meqë, komuna e Mitrovicës Veriore ende nuk është themeluar, nuk ekziston kod i veçantë për të, që do të mundësonte transferimin e buxhetit të saj. Buxheti shkon në një njësi të linjës së komunës së Mitrovicës (si nën-linjë) që aktualisht **administrohet** nga AUM për administratë, shërbime publike, shëndetësi, arsim dhe shërbime të tjera për Mitrovicën veriore.

Në buxhetin e vitit 2012, duke u bazuar në opsionet e politikave të reja të cekura më lartë, Qeveria e Kosovës do të ndërpresë financimin për AUM dhe do t’i kaloj burimet buxhetore te ZAMV-ja. Punonjësit e AUM janë të mirëpritur të aplikojnë për pozita në ZAMV por ata duhet të plotësojnë kushtet e vendit të punës dhe të bëhet verifikimi i të kaluarës për ta.

Sapo që Qeveria e Kosovës të shpallë themelimin e ZAMV-së, do të shpërbëhet Zyra Ndërlidhëse e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në Mitrovicën Veriore dhe pagesa e pagave të personelit do të ndërpritet menjëherë. Pozitat e EPK-së do të vazhdojnë për 40 ditë pas shpalljes së themelimit të ZAMV-së. Fushështrirja e punës së pozitive të EPK-së pasqyrohet në funksionet e ZAMV-së. Anëtarët e EPK-së dhe punëtorët e zyrës ndërlidhëse të MAPL-së mund të aplikojnë për ndonjë pozitë në administratën e re.

Shtojca I. Struktura organizative e propozuar me fushat kryesore të aktiviteteve të ZAMV-së



Shtojca II. Kriteret për përzgjedhjen e Zyrtarit Kryesor Ekzekutiv të ZAMV-së

Kushtet/kriteret e përzgjedhjes për Zyrtarin kryesor Ekzekutiv të ZAMV-së

Preferohet që kandidati të ketë qenë banor i Mitrovicës Veriore për të paktën 3 vite¹ dhe preferohet nga grupi etnik shumicë në Mitrovicën Veriore, por që është në gjendje të përfaqësoj të gjitha komunitetet etnike.

Ai/Ajo duhet të ketë:

- Diplomë universitare ose të paktën 5 vite përvojë menaxhuese në administratën publike ose organizimin e komunës
- Shkathtësi të shkëlqyera gjuhësore në serbisht, shqip, dhe preferohet në anglisht dhe njohuri të mira në kompjuter
- Njohuri të kornizës ligjore të qeverisjes lokale dhe marrëdhënieve ndërqeveritare
- Njohuri dhe kuptim të shkëlqyer të buxhetit komunal dhe zhvillimit të menaxhimit financiar dhe proceseve të planifikimit
- Njohuri të parimeve të menaxhimit të përgjithshëm dhe administratës publike
- Njohuri të proceseve të zhvillimit lokal dhe përfshirjes së komuniteteve
- Përvojë në menaxhimin e ekipeve dhe proceseve
- Përvojë pune me institucionet publike
- Përvojë në ofrimin e shërbimeve qytetarëve
- Përvojë pune me qytetarët për mobilizimin e komunitetit

Shkathtësitë Administrative

- Aftësia për të njohur, analizuar dhe zgjidhur situatat, problemet dhe konfliktet
- Aftësia për të vendosur qëllime, organizuar punën, vendur prioritete dhe për të arritur afatet kyçe
- Aftësia për t'i alokuar resurset në mënyrë adekuate për të arritur objektivat
- Aftësia për të punuar nën presion

Shkathtësitë e lidershipit

- Aftësia dhe përvojë e mëhershme për punë me grupe të ndryshme etnike
- Aftësia për të motivuar njerëzit dhe për të ndërtuar aleance për arritjen e qëllimit të dëshiruar
- Aftësia për të marrë përsipër dhe për të inicuar veprime
- Aftësia për të planifikuar, organizuar dhe marrë pjesë në mbledhje në të cilat burimet kolektive anëtarëve të grupit shfrytëzohen në mënyrë efikase
- Hapshmëria ndaj novacioneve dhe kreativitetit

¹ Ligji për Zgjedhjet Lokale i Republikës së Kosovës, neni 9.2

Shkathtësitë e komunikimit

- Aftësia për t'i njoftuar njerëzit për vendimet, ndryshimet dhe informatat tjera relevante me kohë
- Aftësia për të folur në mënyrë efektive sy më sy dhe para grupeve, për të bërë prezantime efektive dhe për të ju përgjigjur pyetjeve dhe për të përcjellë kuptimin e komenteve të tjerëve.

Përveç tjerash kandidati i suksesshëm duhet të punojë në një mënyrë konsultative dhe gjithëpërfshirëse me komunitetin lokal. Kjo nënkupton themelimin e komiteteve konsultative brenda sektorëve nga ana e kandidatit të suksesshëm për t'iu mundësuar qytetarëve të marrin pjesë në procesin e vendim-marrjes.

Shtojca III. Fusha e aktiviteteve të detajuara të propozuara për drejtoritë e ZAMV-së

DREJTORIA	FUSHA E AKTIVITETEVE
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	<p>Organizon dhe koordinon aktivitetet e njërive/ drejtorive të ZAMV-së (p.sh. adresimi i çështjeve logjistike).</p> <p>Menaxhon burimet njerëzore.</p> <p>Ofron asistencë ligjore dhe harton rregulloret.</p> <p>Përgatit politikat dhe strategjitë.</p> <p>Menaxhon prokurimin e mallrave dhe shërbimeve.</p> <p>Adreson çështjet e integritit në BE (bashkëpunimi me MAPL-së dhe Ministrinë e Integritimit Evropian).</p> <p>Koordinon aktivitetet me organizatat donatore.</p> <p>Menaxhon bashkëpunimin me komunat e tjera.</p> <p>Menaxhon informatat dhe raportimin.</p> <p>Përgatit dhe kryen regjistrimin civil.</p> <p>Organizon lëshimin e certifikatave si certifikatat e lindjes, certifikatat e vdekjes dhe të tjerat.</p>
Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik	<p>Menaxhon të hyrat buxhetore.</p> <p>Menaxhon shpenzimet e buxhetit.</p> <p>Mbikëqyrë alokimin e resurseve buxhetore.</p> <p>Mbanë të dhëna për veprimet financiare.</p> <p>Harton raportet financiare dhe dorëzon raportet te organet përkatëse.</p> <p>Promovon zhvillimin ekonomik lokal.</p> <p>Ofron informata dhe këshilla për të cilat bizneset kanë nevojë.</p> <p>Nxit dialogun me bizneset, organizatat e tyre dhe institucionet e qeverisë qendrore.</p>
Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Investimeve në Infrastrukturë	<p>Siguron mirëmbajtjen e parqeve, rrugëve, trotuareve, parkingjeve, shenjave, varrezave, ndriçimit publik, shesheve dhe transportit lokal.</p> <p>Përgatit dhe propozon veprime për të adresuar përdorimin e hapësirave publike komunale.</p> <p>Projekton dhe zbaton projekte të investimeve relevante.</p> <p>Monitoron dhe analizon funksionimin e shërbimeve publike: uji dhe ujërat e zeza.</p> <p>Përgatit dhe propozon veprime për të përmirësuar shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza (duke përdorur mekanizmat e nënkontraktimit).</p> <p>Përfaqëson (nëse do të bëhet e mundur) Mitrovicën Veriore në Bordin Mbikëqyrës të Kompanive të Shërbimeve Publike Rajonale.</p> <p>Zhvillon një plan të menaxhimit të mbeturinave lokale.</p>
Drejtoria e Çështjeve të Komuniteteve Lokale dhe Marrëdhëniet me	<p>Bashkëpunon me OJQ-të dhe grupet e komunitetit.</p> <p>Forcon rolin e shoqërisë civile në monitorimin e aktiviteteve të ZAMV-së.</p>

Publikun	<p>Bashkëpunon me mediat elektronike dhe ato të shkruara (radio, televizion, dhe gazeta e revista) për të siguruar informim të duhur të aktiviteteve të ZAMV-së.</p> <p>Përgatit dhe zbaton mekanizma të ndryshëm të komunitetit për të promovuar aktivitetet e ZAMV te qytetarët (p.sh. radio, panove reklamuese).</p>
Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Shëndetit	<p>Mbledh dhe analizon të dhënat për të përcaktuar prioritetet lokale dhe vlerësuar nevojat lokale.</p> <p>Bashkëpunon me qendrat e mirëqenies sociale përfshirë këtu jetimoret, azilet për nënat e vetme, të moshuarit dhe njerëzit me të meta, banim për të pastrehët si dhe qendrën për kujdesin ndaj fëmijëve.</p> <p>Përcakton nevojat lokale për kujdesin e shëndetit primar, ambulancat për raste urgjente.</p> <p>Organizon dhe menaxhon ofrimin e shërbimeve shëndetësorë që mungojnë.</p> <p>Mbikëqyr situatat epidemike në nivel lokal.</p> <p>Eksploron mundësitë e adresimit për strehimin social.</p> <p>Komunikon dhe bashkëpunon me organizatat dhe institucionet duke adresuar mirëqenien sociale (p.sh. Ministria e Mirëqenies Sociale).</p>
Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastrës dhe Inspeksionit	<p>Monitoron çështjet e planifikimit urban dhe kadastrës për t'u përgatitur për shërbimet e mundshme në të ardhmen.</p> <p>Inicon bashkëpunimin me institucionet e ndryshme në planifikimin urban (në rast të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, Planit të Zhvillimit Urban dhe Planeve Rregullative Urbane në përputhje me Ligjin për Planifikimin Hapësinor).</p> <p>Inicon punën në hartimin e akteve normative komunale (rregulloreve, vendimeve për planifikimin urban dhe rural, lejet e ndërtimit – në përputhje me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe Ligjin për Ndërtimin).</p> <p>Inicon bashkëpunimin me entitetet e tjera për regjistrimin e ndërtimeve publike dhe komerciale.</p> <p>Regjistron dhe verifikon të gjitha ndërtimet publike dhe komerciale.</p> <p>Përgatit dhe propozon veprime për të themeluar lejet e ndërtimit dhe inspektimin e ndërtimeve.</p>
Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit	<p>Organizon dhe menaxhon shërbimet që mungojnë dhe ato të nevojshme brenda sektorit.</p> <p>Angazhon liderët lokal dhe organizatat në aktivitetet brenda sektorit.</p> <p>Organizon konkurse për zbatimin e projekteve të vogla.</p> <p>Planifikon dhe zbaton aktivitete që fokusohen te rinia.</p>

Shtojca IV: Legjislacioni relevant

Pika 1:

Ligji për vetëqeverisje lokale (Ligji # 03/L-40) – nenet 17-23

Neni 17 – Kompetencat vetanake

- a) zhvillimin lokal ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- e) mmbrojtjen e mjedisit lokal;
- f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtë lokale;
- g) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut
- j) ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
- k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- l) banimin publik;
- m) shëndetësinë publike;
- n) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- o) emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapsirës publike;
- q) turizmit;
- r) aktivitetet kulturore dhe të lira;
- s) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është parcaktuar një autoriteti tjetër;

Neni 18 – Kompetencat e deleguara

18.1 Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës u delegojnë përgjegjësi komunave, në pajtim me ligjin, për kompetencat vijuese:

- a) shënimet kadastrale;
- b) regjistrimin civil;
- c) regjistrimin e votuesëve;
- d) regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- e) distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
- f) mbrotja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga

autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria;

18.2 Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës mund t'u delegojnë kompetenca shtesë komunave, nëse është e nevojshme, në pajtim me ligjin.

18.3 Kompetencat e deleguara duhet, në të gjitha rastet, të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 19 - Kompetencat e zgjeruara komunale

19.1 Disa komuna, për të cilat jepet shpjegim më poshtë, kanë kompetencat e tyre të zgjeruara vetanake në fushën e shëndetësisë, edukimit dhe do të kenë të drejtë për të marrë pjesë në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore, siç përcaktohet në nenet që vijojnë.

19.2 Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës monitorojnë ushtrimin e kompetencave të zgjeruara në pajtim me legjislacionin qendror, që parasheh qasje të barabartë në shërbimet publike; standarde minimale sasiore dhe cilësore në ofrimin e shërbimeve publike; kualifikime minimale të personelit dhe trainimit të tyre, parimet e përgjithshme për licencim dhe akreditim të ofruesëve të shërbimeve publike.

19.3 Komunat që ushtrojnë kompetenca të zgjeruara komunale mund të bashkëpunojnë me çdo komunë në ofrimin e shërbimeve të tilla.

Neni 20 - Kompetencat e zgjeruara në përkujdesin dytësor shëndetësor

Komuna e Mitrovicës Veriore, Graçanicës dhe Shtërpcës kanë kompetenca për ofrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të përkujdesit shëndetësor, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e personelit dhe administratorëve të përkujdesit shëndetësor.

Neni 21 - Kompetenca të zgjeruara në shkollimin universitar

Komuna e Mitrovicës Veriore ka kompetencë për shkollim të lartë, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve shkollore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve arsimor.

Neni 22 - Kompetencat e zgjeruara në fushën e kulturës

22.1 Të gjitha komunat, në të cilat komuniteti serb është shumicë, kanë kompetenca për të ushtruar përgjegjësitë për çështjet kulturore, duke përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe religjioze serbe dhe të tjerëve, brenda territorit komunal, si dhe për mbështetjen e komunitetve lokale religjioze, në pajtim me ligjin në zbatim.

22.2. Komunat mund të bashkëpunojnë me çdo komunë tjetër në çështjet kulturore.

Neni 23 - Të drejta të zgjeruara për pjesëmarrje në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore lokale

Komunat, në të cilat komuniteti serb është shumicë, kanë kompetenca për të ushtruar të drejta të zgjeruara për pjesëmarrje në zgjedhjen e komandantit lokal, sipas ligjit për policinë.

Pika 2:

Ligji për vetëqeverisje lokale (Ligji # 03/L-40)

Neni 58 - Përgjegjësitë e kryetarit

Kryetari i komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:

- a) përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
- b) udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikqyr administrimin financiar të komunës;
- c) ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite kuvendit të komunës apo komiteteve të tij;
- d) ekzekuton aktet e kuvendit të komunës;
- e) emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj;
- f) emëron dhe shkarkon anëtarët e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- g) organizon punën dhe drejton politikën e komunës;
- h) propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në kuvendin e komunës;
- i) propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- j) raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës; dhe
- k) mund të kërkojë që kuvendi i komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cënon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve.
- l) do të konsultojë nënkryetarin për komunitete për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin joshumicë; dhe
- m) Aktivitetet tjera që i caktohen me statut.

Pika 3:

Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës

Shtojca III, Neni 13-Mitrovica

13.1 Në territorin e komunës aktuale të Mitrovicës do të krijohen dy komuna të reja, Mitrovica Veriore dhe Mitrovica Jugore, me kufij komunal të përcaktuar në shtojcën e këtij Shtojca III.

13.2 Do të krijohet një bord i përbashkët i komunave të Mitrovicës Veriore dhe Mitrovicës Jugore, i cili do të zhvillojë bashkëpunim funksional në fushat e kompetencave të tyre, sipas marrëveshjes mes vetë komunave.

13.3 Bordi i përbashkët do të përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, me nga pesë (5) përfaqësues të zgjedhur nga secila komunë dhe një (1) përfaqësues ndërkombëtar që do të zgjidhet nga PCN-ja. Bordi i përbashkët do të udhëhiqet nga përfaqësuesi ndërkombëtar.

13.4 PCN-ja do të hapë një zyrë të ndarë në Mitrovicë, e cila posaçërisht do të përqendrohet në fushat e sigurisë / sundimit të ligjit, lirisë së lëvizjes / kthimit, të drejtat pronësore / të banimit, dhe zhvillimin ekonomik, siç parashihet në Shtojcën IX të kësaj zgjidhjeje.

13.5 Gjatë periudhës tranzicionit prej 120 ditësh, PSSP-ja do të krijojë strukturat e përkohshme komunale në bashkërendim me PCN-në për komunën e re të Mitrovicës Veriore, sipas kufijve të përcaktuar në Shtojcën e këtij Shtojca. Pas përfundimit të periudhës së tranzicionit, këto struktura të përkohshme komunale do të mbesin nën autoritetin e PCN-së deri në mbajtjen e zgjedhjeve të para lokale në këtë komunë.

Pika 4:

Ligji për Kufijtë Administrativ të Komunave (Ligji Nr. 03/L-041)

Neni 7 - Bordi i Mitrovicës

- 7.1 Komuna e Mitrovicës Veriore dhe komuna e Mitrovicës së Jugut formojnë një Bord të Përbashkët funksional.
- 7.2 Bordi do të zhvillojë bashkëpunim funksional në sferat e kompetencave vetanake të komunave.
- 7.3 Bordi do të përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, me nga pesë (5) përfaqësues të zgjedhur nga secila komunë, dhe një (1) përfaqësues ndërkombëtar i zgjedhur nga PCN i cili kryeson Bordin.
- 7.4 Përfaqësuesi i zgjedhur nga PCN, do të kryesoj Bordin.

Pika 5:

Ligji për Kufijtë Administrativë të Komunave (Ligji Nr. 03/L-041) dhe Neni 13, dhe Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës_Shtojca III, neni 12.2.2 – Vazhdimi i Funksionimit

Neni 13 - Komunat ekzistuese vazhdojnë të funksionojnë dhe të ofrojnë shërbime edhe në pjesët që do t'i përkasin komunave të reja deri në konstituimin e kuvendeve komunale të komunave reja të themeluara me këtë ligj.

Pika 6:

Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës

Shtojca III, neni 12.2 – Themelimi i Komunave të Reja

12.2.1 PCN-ja, në këshillim me komunitetet lokale në komunat e reja, apo në rastin e Novobërdës, në zonat e reja kadastrale dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, do të emërojë ekipe përgatitore komunale (EPK) për t'u përgatitur për krijimin e komunave të tyre të reja përkatëse dhe detyrat tjera të ndërlidhura siç kërkohet nga PCN-ja.